



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 19

Prishtinë, më 22.5.2018, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Daut Haradinaj, Lutfi Zharku, Andin Hoti, Danush Ademi, Ganimete Musliu, Enver Hoti, Salih Salihu, Srđan Mitrović, Liburn Aliu, Driton Çausi.

Munguan: Besa Gaxherri,

Stafi mbështetës i Komisionit: Bajram Badivuku dhe Ylber Sherifi, Editë Mehmeti

Mbledhjen (intervistimin) e kryesoi, **Daut Haradinaj**, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Intervistimi i kandidatëve për drejtor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës

Daut Haradinaj, kryetar, përshëndeti anëtarët e komisionit dhe para se të filloi intervistimi i kandidatëve, kërkoi nga kryesuesi i GP Liburn Aliu njoftimin në cilin fazë është GP me shqyrtimin e projektligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje. Pasi që **Liburn Aliu** njoftoi se është në fazën përfundimtare dhe amendamenti ka përfunduar, kryetari caktoi mbledhjen për ditën e nesërme më 23.5.2018 për shqyrtimin përfundimtar dhe dërgimin për leximin e dytëtë këtij projektligji.

Komisioni pastaj duke i ftuar një nga një, zhvilloi intervistën me 11 kandidatë, që i janë përgjigjur ftesës, si vijon: **Bislim Zogaj, Visar Haxhibeqiri, Arsim Kajtazi, Ragip Zejnullahu, Esat Brajshori, Bujar Demjaha, Bashkim Hasani, Arbër Hadri, Milazim Hajredini, Mursel Racaj dhe Besim Mulaj.**

Komisioni pas tërheqjes në këshillim dhe votim, vendosi si vijon :

P Ë R F U N D I M

Në bazë të vlerësimit të kandidatëve, Komisioni përgatiti listën e ngushtë me 2 kandidatë për pozitën e drejtorit të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës: **Bislim Zogaj** (78 pikë) dhe **Besim Mulaj** (73 pikë), për votim në Kuvend.

Intervistimi dhe votimi përfundoi në orën 12,00.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit,
Daut Haradinaj